



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDËTIT PUBLIK

Analiza epidemiologjike mujore (Pasqyra 14 Sh)


ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE MUJORE

DHJETOR, 2017

Analiza epidemiologjike e sëmundshmërisë infektive bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Pasqyra 14-Sh plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me poste elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, ISHP brenda datës 10 të çdo muaji. Në muajin janar 2018 kanë raportuar 36 rrethe.

❖ Sëmundjet diarreike

Gjatë muajit dhjetor 2017 vëmë re se kemi të njëjtën incidencë të sëmundjeve diarreike për 100.000 banorë (165.6) krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, nëntor 2016, incidenca 168.8. Numri i rasteve sipas çdo nozologjie për muajin dhjetor 2017 duke e krahasuar me muajin dhjetor 2016 paraqiten në grafikun e mëposhtëm:




Grafiku 1. Numri i rasteve me sëmundje diarreike, dhjetor 2016 dhe 2017 të raportuara nga DRSH/DSHP-te.

Rrethi me numrin më të madh të rasteve me Salmonelozë jotifioide për muajin dhjetor 2017 është Shkodra me 18 raste të konfirmuara.

Rastet e raportuara me Shigelozë janë: Shkodër 15 raste të konfirmuara dhe Kukës 2 raste të suspektuara sepse për shkak të pamundësisë të laboratorit rastet nuk konfirmohen në laborator.

Numri i toksikoinfeksioneve alimentare në dhjetor 2017 ka një rënie në krahasim muajin dhjetor 2016 dhe rrethet me problematike janë: Bulqizë (88), Kukës (66), Berat (21) dhe Gjirokastra 8 raste.

Gastroenteritet e paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha qarqet e vendit. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së sakte klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.




Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas DRSH/DSHP-ve, dhjetor 2016 dhe 2017.

❖ Zoonozat


	Dhjetor (Raste2017)	Incidenca (raste/100,000) 2017	Dhjetor (Raste 2016)	Incidenca (raste/100.000) 2016
Antraks (Plasje)	0	0	0	0
Brucelozë	5	0.1	7	0.2
Leptospirozë	2	0.07	3	0.1
TBc ekstrapulmonar	5	0.1	7	0.2
Rikecie	1	0.03	0	0

Tabela 1. Shpërndarja e zoonozave numri total i rasteve (Bruceloze, Antraks, Leptospirozë, Tbc ekstrapulmonar, Rikecie) në muajin Dhjetor 2017 krahasuar me muajin Dhjetor 2016.



Grafiku 3. Shpërndarja e zoonozave (Antraks,Brucelozë, Tbc ekstrapulmonar, Leptospirozë,Rikecioze) në numër total rastesh në muajin Dhjetor 2017 krahasuar me muajin Dhjetor 2016.

BRUCELOZA




Grafiku 4: Shpërndarja gjeografike e Brucelozës sipas rretheve në muajin Dhjetor 2017 krahasuar me muajin Dhjetor 2016.

Në total në muajin Dhjetor 2017 janë raportuar 5 raste me Brucelozë kundrejt 7 raste të raportuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rastet janë raportuar nga rrethet Pogradec (2 raste), Diber, Kuçovë, Shkodër, përkatësisht me nga 1 rast.

ANTRAKSI

Antraksi rezulton me 0 raste raportimi për muajin Dhjetor 2017 krahasuar me po të njëjtën periudhë të muajit Dhjetor 2016.


LEPTOSPIROZA



Grafiku 5. Shpërndarja gjeografike e Leptospirozës sipas rretheve në muajin Dhjetor 2017 krahasuar me muajin Dhjetor 2016

Në total për muajin Dhjetor 2017 janë raportuar 2 raste me Leptospirozë kundrejt 3 rasteve të raportuar në muajin Dhjetor 2016. Rastet e raportuara në muajin Dhjetor 2017 i përkasin rretheve Shkodër (1 rast) dhe Tirana (1 rast).

TBC EKSTRAPULMONAR



Grafiku 6: Shpërndarja gjeografike sipas rretheve e Tbc ekstrapulmonar Dhjetor 2017 krahasuar me muajin Dhjetor 2016.

Nga të dhënat e raportuara në muajin dhjetor 2017 rezultojnë 5 raste me TBC ekstrapulmonar rastet i përkasin rretheve Tirane 4 raste dhe 1 rast nga rrethi Mirdite. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016 vërehet një ulje e lehtë e numrit të rasteve të raportuara.

Rikecie (1 rast) i raportuar në Dhjetor 2017 kundrejt 0 raste të raportuar në Dhjetor 2016. Rasti i raportuar i përket rrethit Elbasan.

❖ Sëmundjet e PKI

Fruthi:

Në muajin dhjetor në pasqyrën 14 sh janë raportuar në total 6 raste me fruth nga të cilët 3 raste kanë rezultuar pozitiv për IgM ndaj Fruthit në Laboratorin e Virologjisë, ISHP dhe tre raste negative.

Nga rrethi i Pogradecit janë raportuar 4 raste të moshës pediatrike tre nga të cilët kanë rezultuar pozitivë për IgM ndaj Fruthit dhe një rast negativ.

Dy raste janë raportuar nga rrethi i Tiranës, të cilat rezultuan negative për IgM ndaj Fruthit.

Varicele:

Rastet me varicele hasen kryesisht në grupmoshën pediatrike 0-14 vjeç dhe në kolektiva të mbyllura si institucionet parashkollore çerdhe kopshte dhe shkolla në formë shpërthimesh të kufizuara.

❖ Ethe hemorragjike


Nga survejanca e bazuara në rast, gjatë periudhës Dhjetor 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë Dhjetor 2016, është vënë re një trend shumë i ulët i rasteve të dyshuara me ethe hemorragjike, vetëm një rast të dyshuar në muajin Dhjetor 2017 i cili rezultoi negativ për EHKK. (Tabela. 2)

Periudha	Raste të dyshuara	Raste të konfirmuara
Dhjetor 2016	0	0
Dhjetor 2017	1	0

Tabela 2. Totali i rasteve të dyshuara me diagnozën Ethe hemorragjike gjatë periudhës Dhjetor 2016 dhe Dhjetor 2017

❖ Meningoencefalite

Për sa i përket rasteve të dyshuara me diagnozën Meningoencefalite, duke u mbështetur në të dhënat e Pasqyrës 14 Sh dhe survejancës bazuar në rast, është vënë re një trend në rritje të rasteve të dyshuara me meningit viral gjatë periudhës Dhjetor 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Ndërkohe në lidhje me rastet meningit bakterial jo meningokoksik dhe rasteve të me encefalit të paspecifikuar, kemi një rënie të numrit të rasteve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, 2016.



Grafiku 7. Totali i rasteve të dyshuara meningoencefalite gjatë periudhës Dhjetor 2016 dhe Dhjetor 2017

Gr. Moshë	<1vjeç	1-4 vjeç	5-14 vjeç	15-24 vjeç	25-44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç
-----------	--------	----------	-----------	------------	------------	------------	----------

Raste	0	1	0	0	4	2	1
-------	---	---	---	---	---	---	---



Tabela 3. Totali i rasteve te dyshuara meningoencefalite gjate periudhës Dhjetor 2016 dhe Dhjetor 2017

Theksojmë qe gjate muajit Dhjetor te viteve 2016 dhe 2017, nuk kemi asnjë rast te raportuar te dyshuar me meningit bakterial meningokoksik dhe tuberkular. Ne lidhje me totalin e meningoencefaliteve gjate periudhës Dhjetor 2016 dhe Dhjetor 2017, kemi predominim te gjinisë meshkuj, me hasje ne nivel me te larte ne grupmoshën e rritur (Tabela 3). Theksojmë qe rastet janë raportuar dhe hetuar njëkohësisht nga DSHP, sektori epidemiologjisë, ne rrethet Tirane(4 raste), Vlore (1 rast), Shkodër (1 rast), Durrës (1 rast) dhe Elbasan (1 rast).

❖ Sifilizi

Gjatë muajit dhjetor 2017 ka pasur 2 raste Sifiliz latent të raportuar nga Korça. Rastet i përkasin grupmoshave 25-29 vjeç dhe 45-49 vjeç.


❖ Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te semundshmerise infektive gjate muajit dhjetor 2017 janë raportuar ne total 56 raste me hepatite virale akute nga te cilat 13 raste janë Hepatite virale te paspecifikuar, 16 raste me Hepatit viral akut B dhe 1 rast me Hepatit virale as A as B. (tabela 4)

Periudha kohore	Hepatiti I paspecifikuar	Hepatit viral A	Hepatit viral B	Hepatit viral as A as B
Dhjetor 2016	7	3	14	2
Dhjetor 2017	13	0	16	1

Tabela 4

Siç shihet edhe nga grafiku 1, ne krahasim me te njëjtin muaj një vit me pare, numri rasteve te raportuar me hepatite virale akute ka pësuar rritje për hepatitin e paspecifikuar dhe hepatitin viral B. Ndërkohë këtë muaj nuk ka patur asnjë rast me hepatitin viral A.



Grafiku 8. Numri i rasteve me hepatite virale, dhjetor 2016 dhe 2017.

Duhet theksuar se rastet me Hepatit viral te paspecifikuar gjate muajit dhjetor te vitit 2017 i perkasin grupmoshës 1-14 vjeç (9 raste), grupmoshës 15-24vjec (1 rast), grupmoshës 45-59 vjeç 3 raste.

Persa i perket HBV 10 raste i perkasin moshës 25-44 vjeç, 4 raste grupmoshës 45-59 vjeç dhe 2 raste grupmoshës mbi 60 vjeç. Ndërsa rasti me hepatit as A as B është nga 45-59 vjeç.

Nga hetimi epidemiologjik i kryer për këto raste rezultoi se janë raste sporadike pa lidhje epidemiologjike mes tyre.

Ne lidhje me shpërndarjen sipas rretheve, gjate këtij muaji Dibra, Bulqizë dhe Shkodra ka raportuar rastet me Hepatite virale te paspecifikuar ndërsa rasti me Hepatit as A as B është nga Elbasani. Këtë muaj Shkodra ka raportuar 4 raste me HBV dhe Korça 8 rastet e tjera.

Vazhdimi i raportimit te rasteve me hepatit viral te paspecifikuar ndodh për shkak te kapaciteteve te pamjaftueshme laboratorike për diagnostikimin e tyre ne laboratorët mikrobiologjike te DSHP ne rrethet e vendit.


❖ Tuberkulozi pulmonar

Gjate periudhës Dhjetor 2017, krahasuar me muajin Dhjetor 2016, vihet re një ulje e lehtë e numrit të rasteve të raportuara me tuberkuloz pulmonar nga 24 raste ne Dhjetor 2016 në 21 raste në muajin Dhjetor të vitit 2017. Burimi i te dhënave për të dy periudhat e krahasuara është Programi Kombëtar i Tuberkulozit pranë SUSM.

Sipas SMBS ne muajin Dhjetor 2016 janë raportuar 27 raste (19 meshkuj dhe 8 femra), ndërsa ne muajin Dhjetor 2017 janë raportuar 20 raste (15 meshkuj dhe 5 femra).

Duke krahasuar te dhënat e dy burimeve, sipas SMBS për muajin Dhjetor 2016 shikojmë se kemi një raportim te 3 rasteve me shume (27 raste) nga 24 rastet qe janë raportuar nga Programi Kombëtar i Tuberkulozit, ndërsa te dhënat e dy burimeve për muajin Dhjetor 2016 ndryshojnë me 1 rast me shume ne krahasim me te dhënat e Programit Kombëtar te Tuberkulozit.


Persa i përket shpërndarjes sipas rretheve ne te dyja periudhat, Tirana paraqet numrin me te larte te rasteve, përkatësisht 12 raste ne Dhjetor 2016, me pas Lushnja raporton te njëjtin numër rastesh (4 raste) me TBC pulmonar ne te dyja periudhat.



Grafiku.9. Paraqitja e totalit te rasteve (numer) me diagnozen Tuberkuloz pulmonar, gjate periudhes Dhjetor 2017 dhe Dhjetor 2016.

❖ HIV/AIDS

Survejaca e SMBS ne lidhje me diagnozën AIDS paraqet 1 rast te raportuar nga rrethi Vlore ne muajin Dhjetor 2016. Sipas te dhënave te Programit Kombëtar te HIV/AIDS, gjate muajit Dhjetor 2016 janë raportuar 17 raste HIV pozitive, ndërsa ne muajin Dhjetor 2017 janë diagnostikuar 6 raste HIV pozitive. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve te muajit Dhjetor 2016 paraqet 13 raste tek meshkujt dhe 4 raste i përkasin gjinisë femër; ndërsa ne Dhjetor te 2017, 6 rastet janë meshkuj. Shpërndarja sipas grupmoshës tregon se grupmosha mbi 45 vjeç zë 50% te rasteve ne muajin Dhjetor 2017, ndërsa ne Dhjetor te vitit 2016 grupmosha 25-44 vjeç zë 53% te totalit te rasteve, ndërsa grupmosha e te rinjve 16-24 vjeç zë 17.6% te të gjitha rasteve.



Grafiku 10. Raste te diagnostikuar me HIV, Dhjetor 2016 dhe Dhjetor 2017

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë, Programi Kombëtar i Tuberkulozit**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi, Donika Bardhi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I
SHENDETIT
PUBLIK

DEKSI